



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 19.06.2025
Numër Protokolli: 4603/2025

A.nr.691/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.691/2025, të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 1, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datë 19.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.691/2025, të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Nëpunëve Teknik dhe Mbështetës në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi F.A (*tutje referuar ankuesi*), më datë 19.04.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 22.04.2025, dhe e regjistruar nën shenjen A.nr.691/2025, kundër rezultatit përfundimtar lidhur më Konkursin e jashtëm Nr.01/2025, të datës 05.02.2025, pozita e punës “Dorëzues”, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.05.2025, ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, më datë 16.05.2025, ka dhënë përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit*) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.691/2025, të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 05.02.2025, ka shpallur Konkursin e jashtëm me numër Nr.01/2025, për pozitën e punës Dorëzues, në Departamentin për Logjistikë dhe Infrastrukturë, kategoria funksionale Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës 2, një (1) vend i lirë pune.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesi, dhe se i njëjti ka kaluar fazën e verifikimit paraprake, duke iu nënshtruar edhe fazave të tjera të vlerësimit, gjegjësisht në testin me shkrim ka arritë 59.8, ndërsa, në intervistën me gojë ka arritë 23.6 pikë, gjithsej 82 pikë.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 10.04.2025, ka publikuar listen përfundimtare për rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë, nga rezulton se si kandidatë me më së shumti pike për pozitën përkatëse njëherit edhe si kandidatë fitues është shpallur M.H me 83.6 pikë.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor se ky proces rekrutimi është shpallur përmes shkeljeve ligjore, shton se të gjitha fazat e vlerësimit i ka kaluar me sukses dhe nuk është vlerësuar në mënyrë meritore nga ana e Komisionit të Pranimit. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, dhe të anuloj procesin e rekrutimit në tërsi.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit në pikëpamje lëndore, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik më të cilin është përcaktuar se: Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. *Nëpunësja/i i shërbimit civil*; 1.2. *Nëpunësja/i i shërbimit publik*; 1.3. *Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës*; 1.4. *Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës*; dhe 1.5. *Zyrtarja/i i kabinetit*...2. *Nëpunësja/i i shërbimit civil*, andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke qenë se me ankesë kontestohet procedura e pranimit lidhur me pozitën e kategorisë së Nëpunësit teknik dhe mbështetës, atëherë, në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku parashihet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, rrjedhë së KPMSHCK-ja nuk ka kompetencë lëndore që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.691/2025, të datës 22.04.2025.

Pas konstatimit se Këshilli nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.691/2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike të brendshme pranë organit publik punëdhënës, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 88 të Ligjit Nr.08/L-196 për Zyrtarët Publikë, nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit

Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike-administrative dhe të bartë lëndën të organi kompetent, në këtë rast Komisioni i Ankesave për Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshillë juridike: Ky Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.691/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, F.A;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK;
- Komisionit për Ankesa të Nëpunësve Teknik dhe Mbështetës në SKGJK dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.